



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5767/8 prot.

Pogradec, më 28.12.2021

VENDIM
Nr 118 datë 24.12 2021

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NË KUADËR TË
PROJEKTIT ROMACTED 2 DHE MIRATIMIN E KOORDINATORËVE BASHKIAK
TË PROJEKTIT ROMACTED 2**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , Ligjit Nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr.96 datë 13.10.2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec (VKB) Nr. 22 datë 28.01.2020 "Për miratimin e planit vendor për intergrimin e Komunitetit Rom- Egjiptian 2019-2022 në Bashkinë Pogradec", me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë .

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1- Të Miratojë Memorandumin e mirëkuptimit për projektin ROMACTED 2 (Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit Rom në Nivel Vendor).
- 2- Të Miratojë dy koordinorë Bashkiakë për Programin "ROMACTED 2"
- 3- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet ngarkohet Kryetari i Bashkisë ,Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes .

KRYETARI I KËSHILLI
Sotirag MANGËRI

